



VENDIM

Nr. 92 Datë 06.09.2013

**PER
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PER HEC "KOKA 1"
, TE SHOQERISE "SNOW ENERGY" SH.P.K SI BURIM I
RINOVUESHEM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma "l", 9 dhe 39 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2, germa a, të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.09.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "SNOW ENERGY" sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC "KOKA 1", si burim i rinovueshem energjie.

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë "SNOW ENERGY" sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat "a", "b", "c", "d"**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 2, gërma "a", "b", "c", "d"**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 3, gërma "a", "b", "c"**
Është plotësuar tërësisht



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kërkeses së shoqërisë "SNOW ENERGY" sh.p.k për kualifikim impiantit prodhues për Hec "KOKA 1", si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari në Detyrë
Shkelqim Bozgo